



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c) të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3, nenin 5, paragrafi 5.1.3, nenin 6 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 13.04.2024, nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **Z.Burim Shehu**, emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Kaçanik, nga subjekti politik “Lëvizja Vetëvendosje”, duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Adnan Reka.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t’i komunikohet z.Burim Shehu dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 11.04.2024, Nr.07/479/2024, për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal z.Adnan Reka, i cila ka dhënë dorëheqje, për arsye të angazhimeve tjera.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati i radhës në listën e rirenditur është z.Burim Shehu.

Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë 13.04.2024

Kryesues  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Kreshnik Radoniqi





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 87 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 7 paragrafi 4 Rregullore Zgjedhore Nr.10/2024 Fletëvotimet dhe Broshura, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 13.04.2024, nxjerr këtë:

## VENDIM

**Për miratimin e Numrit të Fletëvotimeve në Vendvotime, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveqan dhe Mitrovicë e Veriut**

- I. Miratohet Numri i Fletëvotimeve në Vendvotime, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveqan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahet me datën 21 prill 2024.
- II. Të dhënat për numrin e fletëvotimeve si në piken I, janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 13.04.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi

Komuna	QV	Lokacioni QV	Vendvotimet	Numri i votuesve	Numri i fletëvotimeve në vendvotim (rumbujaksimi)	2 % e votuesve në nivel komune	Fletëvotime rezervë në KKZ	
12. LEPOSAVIÇ / LEPOSAVIQ	1201	SH.F.M.U. "Leposaviç"	1201/01	909	800			
	1201	SH.F.M.U. "Leposaviç"	1201/02	797	650			
	1201	SH.F.M.U. "Leposaviç"	1201/03	877	750			
	1202	SH.M.L. "Nikola Tesla"	1202/01	858	750			
	1202	SH.M.L. "Nikola Tesla"	1202/02	845	700			
	1203	SH.F.M.U. "Vuk Karadhiç"	1203/01	813	700			
	1203	SH.F.M.U. "Vuk Karadhiç"	1203/02	892	750			
	1203	SH.F.M.U. "Vuk Karadhiç"	1203/03	645	500			
	1204	SH.F.M.U. "Stana Baçanin"	1204/01	920	800			
	1205	SH.F.M.U. "Stana Baçanin"	1205/01	350	300			
	1206	SH.F.M.U. "Stana Baçanin"	1206/01	899	750			
	1206	SH.F.M.U. "Stana Baçanin"	1206/02	936	800			
	1206	SH.F.M.U. "Stana Baçanin"	1206/03	893	750			
	1207	Kontejnerë	1207/01	63	50			
	1208	SH.F.M.U. "Leposaviç"	1208/01	302	250			
	1209	SH.F.M.U. "Leposaviç"	1209/01	485	350			
	1210	Objekt Privat Lovaçki dom	1210/01	107	50			
	1211	SH.F.M.U. "Vuk Karadhiç"	1211/01	197	150			
	1212	SH.F.M.U. "Stana Baçanin"	1212/01	156	150			
	1213	Zyra Lokale per Komunitete	1213/01	350	300			
	1214	SH.F.M.U. "Vuk Karadhiç"	1214/01	336	250			
	1215	Ndërtesë Publike	1215/01	214	150			
	1216	Shtëpi Private pronar - Radosh Kerkez	1216/01	80	50			
	1217	SH.F.M.U. "Leposaviç"	1217/01	442	300			
	1218	SH.F.M.U. "Kadri Blisricë"	1218/01	308	250			
					13674	11300	273	250

Numri i votuesve në Listën Përfundimtare të Votuesve 13674  
 Gjithësej numri i fletëvotimeve që shtypen 11660  
 Numri i fletëvotimeve në vendvotime 11300  
 Numri i fletëvotimeve rezervë në KKZ 250  
 Fletëvotime që shtypen më pak se numri i votuesve 2074 (18.1 %)



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Data / Datum	13.04.2024
Për / Za	Anëtarët e Këshillit për Operacione Zgjedhore
Përmes/Preko	Burim Ahmetaj - Kryeshef Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së
Nga / Od	Kreshnik Spahiu - Drejtor i DTI-së
Kopje / Kopija	Arkivës së KQZ-së
Lënda / Predmet	Rekomandim për miratimin e fletëvotimeve për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut

Të nderuar Anëtarë,

Konform Planit të aktiviteteve, Sekretariati ka përpiluar dokumentin me numrin e fletëvotimeve që rekomandohet të shtypen për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut.

Numri i votuesve sipas Listës së Votuesve të certifikuar nga KQZ është 46556 votues, ndërsa numri i fletëvotimeve që propozohet të shtypen është 40000 fletëvotime apo 6556 ( 14.1 % ) fletëvotime më pak se numri i votuese në këto 4 komuna.

Ndërsa modaliteti i propozuar është:

- a) në vendvotimet me më shumë se 400 votues, shtypen fletëvotime me pak se votues nga -100 deri në -149.

Vendvotimi	Numri i votuesve	Numri i fletëvotimeve në vendvotim (rrumbullakimi)
1201/01	909	800

- b) në vendvotimet që kanë mbi 200 votues dhe më pak se 400 votues, shtypen fletëvotime me pak se votues nga -50 deri në -99.

Vendvotimi	Numri i votuesve	Numri i fletëvotimeve në vendvotim (rrumbullakimi)
1205/01	350	300

- a) në vendvotimet që kanë më pak se 200 votues, shtypen fletëvotime me pak se votues nga -1 deri në -49.

Vendvotimi	Numri i votuesve	Numri i fletëvotimeve në vendvotim (rrumbullakimi)
1207/01	63	50

Bashkangjitur me këtë shkresë janë kalkulimet e detajuara sipas komunave dhe vendvotimeve.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64 paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 8 paragrafi 6, neni 19 dhe neni 21 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 13.04.2024, nxjerr këtë:

## VENDIM

**Për miratimin e Procedurave të Votimit dhe Numërimit, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Lepsaviq, Zubin Potok, Zveqan dhe Mitrovicë e Veriut**

- I. Miratohen Procedurat e Votimit dhe Numërimit, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Lepsaviq, Zubin Potok, Zveqan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahet me datën 21 prill 2024.
- II. Procedurat si në piken I, janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 13.04.2024

Kryesues


Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi





KOMISIONI QENDROR  
I ZGJEDHJEVE



# PROCEDURAT E VOTIMIT DHE NUMËRIMIT NË VENDVOTIM

Procesi i votimit për apo kundër largimit të Kryetarëve nga funksioni  
në Komunat, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut





# Përmbajtja

<b>I. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E PJESËMARRËSVE NË PROCES ZGJEDHOR-</b>	<b>4</b>
KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE	4
KOMISIONI KOMUNAL I ZGJEDHJEVE	5
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)	6
ANKESAT NË PROCES ZGJEDHOR	7
VËZHGESIT DHE MEDIAT	8
ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E POLICISË	8
PERSONELI I QENDRAVE TE VOTIMIT	10
KËSHILLI I VENDVOTIMIT (KVV)	
<b>II. PËRGATITJET PËR VOTIM</b>	<b>23</b>
PARA DITËS SË VOTIMIT	23
DITA E VOTIMIT	29
NË DITËN E VOTIMIT	30
<b>III. PROCESI I VOTIMIT (07:00-19:00)</b>	<b>32</b>
PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E VOTIMIT	32
VOTIMI I RREGULLT	32
VOTIMI ME KUSHT	33
<b>IV. MBYLLJA E VENDVOTIMIT</b>	<b>35</b>
MBYLLJA E QENDRËS SË VOTIMIT	35
MBYLLJA E VENDVOTIMIT (19:00)	35
<b>V. NUMËRIMI I FLETËVOTIMEVE DHE PËRPTHJJA E REZULTATEVE</b>	<b>37</b>
NUMËRIMI I ZARFEVE ME KUSHT	38
NUMËRIMI I VOTAVE	39
<b>VI. FORMULARËT E REZULTATEVE</b>	<b>41</b>
SI TË PLOTËSOHET FORMULARI I PËRPTHJES SË TË DHËNAVE DHE REZULTATEVE FR	41
<b>VII. PAKETIMI</b>	<b>43</b>
PAKETIMI NË VENDVOTIM TË RREGULLT	43
PAKETIMI - NË VENDVOTIM TË DYFISHT	44
<b>VIII. TRANSPORTIMI I MATERIALEVE NË DEPO KOMUNALE</b>	<b>44</b>
TRANSPORTI NË DEPO TË KOMISIONIT KOMUNAL ZGJEDHOR	44
FLETËVOTIMI	45
SHTOJCA 1: FORMULARI I REZULTATEVE (FR)	46
SHTOJCA 2: FORMULAR I KKZ PRANIM DORËZIM	47
SHTOJCA 3: DIAGRAMI I PAKETIMIT	48
SHTOJCA 4: DOKUMENTET E PRANUESHME TË IDENTIFIKIMIT	49
SHTOJCA 5: FORMULARI I ANKESËS I PZAP-SË	50

## TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E PJESËMARRËSVE NË PROCES ZGJEDHOR

Ky Kapitull permban, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e akterëve të ndryshëm që marrin pjesë në një proces zgjedhor në Republikën e Kosovës. Akterët ndahen në dy grupe, të brendshëm dhe të jashtëm. Akterët e brendshëm përbëjnë strukturën organizative, apo trupin menaxhues të zgjedhjeve ku hynë: KQZ, KKZ, Menaxherët e Qendrave dhe KVV, ndërsa akterët e jashtëm përfaqësojnë institucione të ndryshme si: Subjektet politike/Vëzhguesit, Mediat, Policia.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) është organ i përhershëm, i pavarur dhe kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor.

### KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), është themeluar në pajtim me nenin 139 të Kushtetutës së Kosovës, dhe është një organ i përhershëm i pavarur përgjegjës për organizimin, administrimin dhe implementimin e zgjedhjeve në Kosovë.

Roli i KQZ-së është të rregullojë procesin elektoral përmes miratimit të Rregullave Zgjedhore dhe, mbikëqyrjen e procesit zgjedhor në të gjitha aspektet për të siguruar që zgjedhjet të arrijnë standardet ndërkombëtare.

KQZ përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë: nga Kryesuesi dhe dhjetë (10) anëtarë të tjerë. Kryesuesi, emërohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhe zgjidhet mes gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Mandati i Kryetarit të KQZ-së është (7) vjet, duke filluar nga data e caktuar për njoftim të emërimit nga Presidenti i Kosovës. Prerogativat e ushtrimit të detyrës së anëtarit të KQZ-së, caktohen në bazë të ligjit dhe, rregullat për ushtrimin e mandatit. Dhjetë (10) anëtarët e tjerë të KQZ-së, janë emëruar si rezultat i nominimeve të gjashtë (6) grupeve parlamentare më të mëdha të Kuvendit të Kosovës dhe, katër (4) anëtarë që përfaqësojnë komunitetet e vogla në Kosovë.

### KOMISIONI KOMUNAL I ZGJEDHJEVE

Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) është trupe e themeluar nga KQZ. KKZ është organ përgjegjës për t'i administruar zgjedhjet përbrenda Komunës përkatëse, nën mbikëqyrjen ekskluzive sipas udhëzimeve të KQZ-së, duke garantuar ligjshmëri, paanshmëri dhe efikasitet të procesit zgjedhor. KKZ përbëhet nga shtatë (7) anëtar. Mandati i KKZ përfundon pesëmbëdhjetë ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, përveç nëse mandati i KKZ-së ndërpritet para përfundimit të afatit ose zgjatet.

## Përgjegjësitë e KKZ:

- ⇒ **Plani operacional**- zbaton gjitha aktivitetet e parapara në plan
- ⇒ **Fushata zgjedhore**- KKZ zbaton procedurat e parapara për fushatën zgjedhore dhe cakton një anëtar të KKZ, i cili koordinon aktivitetet zgjedhore me institucionet përkatëse.
- ⇒ **Lista e Menaxherëve të QV- KKZ** përpilojnë listën e Menaxherëve të Qendrave të Votimit
- ⇒ **Propozon**- listat e KVV-ve për miratim në KQZ

## PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) është organ i përhershëm, i pavarur dhe kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor.

PZAP-i pranon ankesa në katër faza:

- Ankesa ndaj vendimeve të KQZ
- Ankesa gjatë fushatës pro ose kundër largimit të kryetarëve të komunave
- Ankesa për shkelje në ditën e votimit
- Ankesat pas ditës së votimit

**Afatet:** Gjatë fushatës pro ose kundër largimit të kryetarëve të komunave ankesa duhet të parashtrohet deri në 24 orë pas shkeljes, ndërsa shkeljet që ndodhin në ditën e zgjedhjeve duhet të dorëzohen në PZAP 48 orë pas mbylljes së vendvotimeve.

Kryesuesi i KVV-së është i obliguar të informojë palët e interesuara për të drejtën e tij/saj për të parashtruar ankesë në Panelin e Zgjedhjeve për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) duke i siguruar atij/asaj formularin e ankesës të PZAP-it që ndodhet në kompletin e pajisjeve të VV.

Votuesi duhet të informohet se formulari dorëzohet personalisht, me faks, ose me postë në zyrën e PZAP-it në rrugën "Migjeni" në Prishtinë

### Mandati PZAP

- Organ i pavarur
- Menaxhon të gjitha ankesat dhe shkeljet në lidhje me zgjedhjet

**Formular i Ankesës**– dorëzohet sipas afateve ligjore në PZAP

**Sistemi i Menaxhimit të Rasteve** - Përcjellja e statusit të rastit përmes Sistemit të Menaxhimit të Rasteve (<http://pzap.rks.gov.net>)

**Me rëndësi:** Çdo ankesë që ndërlidhet me procesin e votimit dhe numërimit duhet të dorëzohet në PZAP brenda 24 orëve, nga momenti i shkeljes së supozuar.

**Vendimi** - PZAP ka 96 orë për të marrë vendimin

## ANKESAT NË PROCES ZGJEDHOR

### **Kush ka të drejtë të parashtrijë ankesë?**

Të gjithë qytetarët me të drejtë vote, përfaqësuesit e subjekteve politike, komisionerët e vendvotimeve dhe vëzhguesit vendor kanë të drejtë të parashtrijnë ankesë.

### **Kur janë afatet për dorëzimin e ankeses në PZAP?**

Ankesat lidhur me shkeljet zgjedhore duhen të dorëzohen brenda njëzet e katër (24) orëve nga momenti kur shkelja e supozuar ka ndodhur.

Ankesat dorëzohen në PZAP nëse vërehen disa nga parregullësitë si në vijim, por jo vetëm këto: kërcënim i votuesit, vjedhje e votes, manipulim i rezultateve, votim më shumë se një herë nga një person apo parregullësi tjera gjatë fushatës apo edhe në Qendër të Numërimit të Rezultateve.

Formularin e ankeses e gjeni në çdo vendvotim, apo edhe mund ta shkarkoni nga faqja zyrtare e PZAP <http://pzap.rks-gov.net/> (Shtojca nr.5 e bashkëngjitur në Doracak)

### **Çfarë duhet të përmbajë një ankesë?**

Ankesa që dorëzohet në PZAP duhet të përmbajë: a) emrin, adresën dhe kontaktet e personit i cili është ankuar; b) përshkrimin e detajuar të shkeljes së supozuar, përfshirë edhe datën, kohën, vendin e ngjarjes; c) detajet lidhur me ndonjë dëshmi, ndonjë kopje të ndonjë dokumenti relevant, fotografi, video/audio inqizim, apo lloje të tjera të dëshmive që mbështesin ankesën.

### **Ankesat/Shënimet në Librin e Votimit**

Çdo vendvotim është i pajisur me nga një Libër të Votimit, ku shënohen ngjarjet e rëndësishme në lidhje me procesin e votimit në ditën e zgjedhjeve. Këshillat e vendvotimit dhe vëzhguesit e akredituar mund të shkruajnë direkt në Libër të Votimit ngjarje të rëndësishme rreth procesit të votimit apo të numërimit. Nëse një anëtar i këshillit të vendvotimit kundërshton rezultatet e regjistruara në formular të rezultateve mund të shënojnë vërejtjen e tyre në libër të votimit.

Votuesve nuk iu lejoheq të bëjnë shënime në Librin e Votimit, por në qoftë se ata kanë ndonjë ankesë lidhur me procedurat brenda vendvotimit, ata mund të kërkojnë nga kryesuesi që të shënoj ankesën në librin e votimit dhe pastaj të dorëzojnë ankesë zyrtare në PZAP.

PZAP mund t'i referohet librit të votimit gjatë procesit të hetimit. Informatat e shënuara në librin e votimit mund të rezultojnë në gjykim më efektiv të ankeses.

### **Shkeljet dhe krimet në zgjedhje janë të dënueshme**

Sipas Kodit Penal, kapitulli 18, disa shkelje gjatë procesit zgjedhor paraqesin akte kriminale dhe ato përcjellën direkt në Prokurorinë e Shtetit për hetime të mëtutjeshme. Disa nga këto shkelje janë: a) parandalimi i ushtrimit të së drejtes për të votuar, b) falsifikimi i rezultateve, c) keqpërdorimi i detyres zyrtare gjatë zgjedhjeve, ç) keqpërdorimi i së drejtes së votimit, d) cenimi i fshehtësisë së votimit dh) Cenim i përcaktimit të lirë të votuesit (Votimi familjar).

Kushdo që kryen ndonjëren nga këto vepra mund të denohet nga gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vite burgim.

## **VËZHguesIT DHE MEDIAT**

Vëzhguesit e akredituar të zgjedhjeve luajnë rol të rëndësishëm në integritetin e zgjedhjeve duke e mbrojtur procesin kundër parregullsive e mashtrimeve dhe sigurojnë që rezultatet e zgjedhjeve të jenë të pranueshme për qytetarët e Kosovës. Të drejtat e vëzhguesve përforcojnë transparencën në zgjedhje, duke mundësuar qasje në vëzhgimin e proceseve zgjedhore.

### **Vëzhguesi ka të drejtë të:**

Vëzhgojë, pa u penguar, përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve, përfshirë takimet pas ditës së zgjedhjeve, dëgjimet dhe aktivitetet lidhur me zgjedhjet, ankesat dhe parashtrirat lidhur me rezultatet e zgjedhjeve dhe përcaktimin e kandidatëve fitues;

Ka të drejtë të parashtrijë komente me shkrim KKZ-ve dhe këshillave të vendotimeve;

### **Vëzhguesi ka për detyrë të:**

Mbahë distinktivin e identitetit të vëzhguesit në mënyrë të dukshme kur është i angazhuar në aktivitete të vëzhgimit;

Përmbahet nga bartja e shenjave dalluese të cilat shërbejnë si mjete propaganduese ose që mund të ndikojnë në dëshirën e votuesit ose e identifikon atë me një parti të caktuar politike ose kandidat; dhe

Përmbahet nga shkelja e të drejtës së votuesit për fshehtësi të fletëvotimit dhe nga pengimi i procesit të të votuarit dhe administrimit të procesit.

KQZ në çdo kohë mund ta anulojë akreditimin e vëzhguesit që cenon LZP, Rregulloret e KQZ, urdhëresat ose procedurat administrative lidhur me procesin në fjale.

---

### **Akreditimi dhe roli i mediave**

Vëzhguesi i akredituar i medias duhet ti bartë së bashku distinktivin e akreditimit me dokumentin identifikues të mediumit që përfaqëson dhe sigurohet që të njëjtat të jenë të dukshme gjatë kohës së vëzhgimit dhe ka të drejtë:

Të hyjë në QV, VV dhe QNR, si dhe në objektet tjera të KQZ dhe Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), që janë të hapura për publikun dhe mediat;

Të marrë pamje me kamerë dhe fotografi.

Aktiviteti i stafit të mediave nuk duhet të cenojë integritetin e procesit të votimit, heshtjen zgjedhore, privatësinë dhe fshehtësinë e votës.

### **Roli i vëzhguesve gjatë zgjedhjeve**

Vëzhguesit mund të vëzhgojnë procesin e vlerësimit të pakove me fletëvotime të dërguara nga votuesit jashtë Kosovës, procesin e hapjes së VV, votimin, numërimin, paketimin dhe dorëzimin e materialit nga VV te KKZ, me përjashtim të shënimit të fletëvotimit nga votuesi.

Jo më shumë se një vëzhgues nga organizata e njëjtë e akredituar mund të jetë i/e pranishëm në të njëjtën gjatë proceseve të parapara sikurse në paragrafin 1 të këtij neni.

### **Vëzhgimi i procesit të numërimit të fletëvotimeve në vendvotim nga mediat e akredituara**

Numërimi i fletëvotimeve në vendvotim mund të vëzhgohet nga mediat e akredituara, të cilat lejohen të filmojnë dhe fotografojnë.

Varësisht nga hapësira e VV, kryesuesi i VV cakton numrin e mediave që mund të përcjellin numërimin në një VV.

Përfaqësuesi i medias së akredituar duhet të paraqesë kërkesë te kryesuesi i VV për vëzhgimin e procesit të numërimit në VV e caktuar, para fillimit të procesit të numërimit. kryesuesi i KVV e regjistron kërkesën në librin të votimit, duke shënuar të dhënat e vëzhguesit të akredituar të medias.

Kryesuesi i VV duhet t'i njoftojë mediat se mund të filmojnë procesin e numërimit të fletëvotimeve, por pa paraqitur të dhënat personale të mbrojtura me ligj.

Përfaqësuesit e mediave qëndrojnë në vendin që u caktohet nga kryesuesi, në një largësi të përshtatshme nga tavolinat e punës dhe e kanë të ndaluar të kenë kontakt fizik me materialet zgjedhore, të pengojnë procesin e numërimit të fletëvotimeve apo të komunikojnë me anëtarët e KVV.

Përfaqësuesit e mediave që largohen nga vendvotimi gjatë procesit të numërimit, nuk mund të kthehen prapë në VV.

## **ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E POLICISË**

---

Policia e Kosovës janë të vendosur afër qendrave të votimit në Ditën e Votimit për të ofruar siguri për tërë procesin sipas detyrave dhe përgjegjësi ligjore që ka Policia lidhur me procesin e votimit.

## **PERSONELI I QENDRAVE TE VOTIMIT**

---

### **INFORMATATË PËRGJITHSHME**

Qendra e Votimit (QV) do të thotë ndërtesa ku ndodhet një, apo më shumë VV dhe hapësira e jashtme e saj.

KQZ mund të mos organizojë votimin me kusht, nëse vlerëson se kanë pushuar arsyet e organizimit të tij.

Vendvotimi (VV) është dhoma, salla ose objekti i ngjashëm i caktuar në QV ku do të zhvillohet votimi. Zakonisht vendvotimet janë klasë të shkollave. Për ditën e votimit të 21 prillit KQZ ka caktuar numrin maksimal të votuesve për një vendvotim 950 votues.

Struktura e personelit të qendres së votimit:

- Menaxheri i Qendres
- Personeli i tavolines ndihëmse

## **Përgjegjësitë dhe Detyrat**

### **Menaxheri QV-së**

Një ditë përpara dhe në Diten e Zgjedhjeve, Menaxheri i QV-së është përgjegjës për organizimin dhe planifikimin e të gjitha aktiviteteve teknike në Qendrën e Votimit dhe jashtë ndërtesës (Brenda rrethojës).

Menaxheri i QV është përgjegjës për këto detyra:

- Organizimin dhe planifikimin e të gjitha aktiviteteve teknike në QV;
- pranimin e pakos së materialeve jo të ndjeshme të QV;
- orientimin, qarkullimin dhe qasjen e votuesve në QV;
- raportimin tek KKZ, për mbarëvajtjen dhe gjendjen në QV;
- evidentimin në librin e evidences;
- Pas mbylljes së QV dhe gjatë periudhës së numërimit në VV, Menaxheri i QV sigurohet që të mos jetë prezent asnjë person jashtë VV, përjashtimisht zyrtarët e autorizuar nga KKZ dhe KQZ.
- Raporton ne KKZ per daljen e votuesve per te votuar

## Personeli i Tavinës Ndhmëse

Në hyrjen kryesore të çdo QV duhet të vendoset së paku një tavolinë ndihmëse që shërben për orientimin dhe informimin e votuesve. Tavolina ndihmëse duhet të jetë e pajisur me LV në formatin elektronik. Tavolina ndihmëse duhet të jetë e pajisur me formularët për ankesa dhe parashtrësia që i drejtohen PZAP, nëpërmjet të cilave votuesit mund të ankohen në PZAP gjatë ditës së votimit në rast se kanë vërejtje.

Personeli i Tavinës Ndhmëse është përgjegjës për këto detyra:

- Orientimin e votuesve në vendvotime, sipas LV;
- raportimin e pjesëmarrjes së votuesve;
- raportimin e rezultateve preliminare, bazuar në të dhënat e KVV, sipas udhëzimeve nga KQZ.

Në çdo QV duhet të ketë edhe shabllone me alfabetin e brajl-it dhe KVV të trajnuar për votimin e personave të verbër, të cilët do t'u shërbejnë votuesve të verbër në atë QV.

## KËSHILLI I VENDVOTIMIT (KVV)

KVV është trup menaxhues zgjedhor, i themeluar nga KQZ, i cili është përgjegjës për përgatitjen dhe administrimin e procesit të votimit dhe numerimit të Vendvotimit (VV).

Përbërja e KVV reflekton strukturën e anëtarëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ).

VV hapet dhe funksionon me pjesëmarrjen e plotë të KVV, prej pesë (5) anëtarë.

Në raste të mungesës së anëtarëve të KVV, KKZ me vendim mund të lejojë hapjen dhe funksionimin e VV me së paku tre (3) anëtarë të KVV.

### POZITAT DHE FUNKSIONET E KVV

- Kryesuesi i KVV-së,
- Kontrolluesi i rreshtit (K. Rr),
- Zyrtari i identifikimit (Zyrtari i ID),
- Zyrtari i të dhënave statistikore dhe
- Dhënësi i fletëvotimit (Dh. F)

Në rastin kur kemi më shumë se pesë (5) anëtarë në një KVV, anëtari i gjashtë (6)

- asiston dhënësin e fletëvotimit, ndërsa anëtari i shtatë (7) kryen funksionin e mbikëqyrësit të kutisë së votimit.

### PARIMET THELBËSORE TË KVV

- Si anëtar i Këshillit të Vendvotimit (KVV), duhet të demonstroni nivel të lartë përkushtimi dhe të vini të përgatitur për kryerjen e detyrave me kompetencë dhe

profesionalizëm duke ofruar shërbim cilësor dhe të sjellshëm për të gjithë votuesit dhe akterët tjerë në mënyrë të barabartë gjatë gjithë ditës së votimit.

- Vijimi trajnimeve, përgatitja vendvotimit paraprakisht, sidhe zbatimi i të gjitha detyrave të caktuara nga Kryesuesi për ditën e votimit.

- Të tregohet kujdes i shtuar për kategoritë e votuesve si: të moshuarit, gratë shtatëzëna, për personat me aftësi të kufizuara, si dhe për votuesit me asistencë.



## KRYESUESI I KVV

Kryesuesi i KVV është përgjegjësi kryesor që ushtron detyren në mënyrë profesionale dhe të paanshme në menaxhimin dhe funksionimin e përgjithshëm të vendvotimit duke kryer detyrat/punen me saktësi dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat e KQZ-së.


### **Kryesuesi është përgjegjës për:**

- Zbatimin e të gjitha procedurave të votimit, numërimit dhe paketimit me përpikëri.
- Cakton detyrat e të gjithë anëtarëve të KVV-së
- Zbatimin e të gjitha procedurave të votimit, numërimit dhe paketimit;
- Evidentimin në librin e votimit dhe raportimi i parregullsive në KKZ;
- Evidentimin në librin e votimit i çdo ngjarje dhe procedurë brenda VV;
- Evidentimin në librin e votimit dhe raportimi lidhur me pjesëmarrjen e votuesve në zgjedhje;
- Menaxhimin dhe mbikqyrë të gjitha operacionet brenda VV;
- Kujdesin dhe ruajtjen e të gjithë materialit zgjedhor në VV.

KQZ publikon në ueb faqe statistikën e pjesëmarrjes në zgjedhje për këto intervale kohore: 09:00, 11:00, 13:00, 15:00, 17:00, 19:00, përveç në rastet kur vendoset ndryshe nga KQZ. Në publikimet e orës 13:00 dhe 19:00 përfshihen statistikën gjinore dhe të grupmoshave.


### Para Ditës së Votimit

- Vijon trajnimin
- Mëson dhe ushtron procedurat e votimit  
| dhe numërimit
- Njoftohet me KKZ
- Pranon materialin jo të ndjeshëm
- Rregullon Vendvotimin duke vendosur shenjat dhe tavolinat




## Para hapjes së VV

- Pranon materialin e ndjeshëm
- Cakton detyrat e KVV
- Kontrollon materialet
- Para hapjes zyrtare shfaq kutinë e votimit | tek të pranishmit
- Vendos lidhëset e sigurisë në kuti
- Regjistron numrat në formular



## Hapja e Vendvotimit - Votimi

- Në ora 07:00 shpall VV zyrtarisht të hapur për votim
- Shënon në Librin e votimit: a) kohën e hapjes dhe emrat e anëtarëve të KVV-së. b) emrat dhe numrat e DI-ve të akreditimit të vëzhguesve të pranishëm.
- Mbikëqyrë zhvillimin e procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim në përputhje me Ligjin//Rregullat e zgjedhjeve
- Siguron që të gjithë formularët e nevojshëm të jenë në vendvotim dhe të plotësohen në mënyrë të saktë.
- Mban kontakte me vëzhgues dhe media



## Mbyllja e Vendvotimit dhe Numërimi

- Mbyll derën e VV (19:00) në bashkpunim me Menaxherin e QV
- Mbyll vrimen e kutisë me lidhëse të sigurisë
- Cakton një anëtar të KVV të dera
- Rregullon hapsiren/tavolinat për numërim
- Mbikëqyrë procesin e numërimit
- Plotëson FR-në.
- Mbikëqyrë paketimin e materialeve
- Transporton materialin e KVV në depon Komunale



## KONTROLLUESI I RRESHTIT

Detyrat e Kontrolluesit të rreshtit janë:

### Votuesi në Vendvotimin e duhur

1. Këshillojnë votuesit të kontrollojnë a janë duke pritur në vv të duhur.
2. Udhëzojnë votuesit të bëjnë gati dokumentet identifikuese.
3. Tregojnë kujdes të shtuar me të moshuarit, dhe personat me aftësi të kufizuara.

### Procesimi i Votuesit

- Detyra kryesore është:
1. kontrollojnë nëse në gishtërinjtë e votuesit ka ngjyrë të dukshme matrikuluese
  2. I drejtojnë tek Zyrtari i Identifikimit

### Menaxhimi turmës

1. Menaxhojnë numrin e personave/votuesve brenda vv në të njëjtën kohë.
2. Mbyllin derën e vendvotimit pasi të udhëzohet nga Kryesuesi.

**Në Ditën e Votimit Votuesit nuk lejohet të hyjë në vendvotim në këto raste:**

1. Kur zbulohet ngjyra në gishtërinjë

2. Kur votuesi refuzon kontrollimin e gishtave

3. Kur ndodhet në vendvotimin e gabuar drejtohet tek tavolina ndihmëse në QV

## ZYRTARI I IDENTIFIKIMIT

Është përgjegjës për identifikimin e votuesit, gjetjen e tij/saj në LV dhe ta udhëzojë të nënshkruhet në LV.

1. I kërkon votuesit dokument të pranueshëm të identifikimit
2. Verifikon identitetin e votuesit duke krahasuar të dhënat si # personal dhe fotografinë në dokument identifikues
3. Gjen votuesin në Listë e Votuesve (LV) dhe e udhëzon ku të nënshkruhet.
  - E drejton Votuesin te Dhënësi i Fletëvotimeve

### Materialet e nevojshme për të kryer detyrën janë:

- Lista e Votuesve (LV)
- Procedurat e votimit dhe numërimit në VV
- Kimik
- Pusulla të letrës

### Për të votuar:

Votuesi duhet të ketë së paku **18 vjet**, të **dëshmojë identitetin** e vet përmes **Dokumentit Identifikues të Republikës së Kosovës**, si dhe ta ketë emrin në Listen e Votueseve në vendvotim apo në Listen e Votueseve të Komunes përkatëse.


Votuesit i mohohet e drejta e votimit në rast se nuk prezanton ndonjërin nga dokumentet zyrtare të pranueshme.

Dokumente të vlefshme të votimit konsiderohen, të gjitha dokumentet e Republikës së Kosovës, siç i parasheh **neni 90 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme**.



**Dokumentet e vlefshme të identifikimit, të lëshuara nga Republika e Kosovës janë:**

- Letërnjoftimi;
- Pasaporta;
- Leja e vozitjes;



### Votimi përmes ndihmësit

Votuesi i cili është me aftësi të kufizuara në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedh fletëvotimin, kur aftësia e tij e kufizuar dëshmohet përmes dokumenteve përkatëse, mund të ndihmohet nga një person tjetër (asistuesi) nga e njëjta QV, i zgjedhur nga votuesi, duke ndjekur procedurën e mëposhtme:

Personi që asiston duhet të jetë i moshës 18 vjeç dhe të ketë një nga dokumentet e

identifikimit të Republikës së Kosovës.

asistuesi e ndihmon vetëm një votues dhe nuk është anëtar i KVV ose vëzhgues i akredituar;

në rastin kur personi i asistuar nuk është në gjendje fizike të nënshkruaj atëherë asistuesi shkruan në LV "PËR: emrin dhe mbiemrin e tij", në hapësirën e votuesit që është asistuar;

kryesuesi i KVV shënon në Librin e Votimit numrin rendor, kohën, të dhënat personale të votuesit dhe të asistuesit si dhe arsyen e saktë të votimit me asistencë. Numri i rastit në Librin e Votimit shënohet në hapësirën e votuesit në LV;


asistuesi mund ta ndihmojë në votim personin me aftësi të kufizuara, duke ia mbajtur dorën dhe mundësor që votuesi të shënojë vetë fletëvotimin. Në rast se votuesi nuk mund ta hedhë fletëvotimin në kuti, atëherë asistuesi e ndihmon këtë proces.



Kryesuesi me anëtarët e KVV dhe vëzhguesit nuk kanë të drejtë të ndihmojnë votuesin.

Ndihmësi ka të drejtë të ndihmojë vetem një herë

Nuk lejohet nënshkrimi i LV përmes "VENJES SË SHENJËS SË GISHTIT"






Nuk vazhdon; E udhëzon të dalë jashtë VV

Nëse votuesi nuk nënshkruan

### HAPI 3

I kërkon votuesit të nënshkruhet pranë emrit

Votuesi nënshkruan



### HAPI 4

Votuesi nënshkruhet në LV dhe vazhdon të dhënësi i Fletëvotimeve


### Kush mund të votojë?

- Votuesi duhet të dëshmoj se: a) është 18 vjeç apo më i vjetër se 18 në Ditën e Votimit b) Votuesi ka të drejtë të votojë vetëm në komunën ku është i regjistruar si qytetar/banor i përhershëm c) të dëshmojë identitetin e vet përmes Dokumentit të identifikimit të pranueshëm, d) emri i tij/saj të jetë i përfshirë në Listen e Votuesve në vendvotim apo në Listën Votuese të Komunës përkatëse.



### Kush nuk lejohet të votojë?

- Votuesi/ja i/e cili/a nuk është së paku 18 vjeç në ditën e zgjedhjeve.
- Votuesi/ja të cilit nuk i figuron emri në Listën e Votuesve (LV) të atij vendvotimi apo në Listen e Votueseve të Komunës përkatëse dhe nuk ka Dokument Identifikimi të pranueshëm.
- Votuesi/ja që refuzon të nënshkruhet në LV; votuesit/es i refuzohet dhënia e fletëvotimit dhe rasti shkruhet në libër të votimit nga Kryesuesi.
- Votuesi nuk lejohet të votoj kur Kontrolluesi i Rreshtit zbulon ngjyrën matrikuluese në gishtërinj të votuesit. Rasti shkruhet në libër të votimit nga Kryesuesi
- Votuesi refuzon shënjimën e gishtit me ngjyrë matrikulare, votuesit i refuzohet dhënia e fletëvotimit- udhëzohet jashtë; në LV te pjesa ku është nënshkruar bëhet me shejë dhe shlyhet nënshkrimi. Rasti shkruhet në libër të votimit.



### Kur Votuesi voton me kusht?

Sipas Ligjit dhe Rregullave për zgjedhje, votuesi voton ME KUSHT në rastet kur:

KQZ-ja përcakton numrin e QV me kusht. KQZ mund të mos organizojë votimin me kusht, nëse vlerëson se kanë pushuar arsyet e organizimit të tij.

Në ditë e votimit, votuesit i lejohet të votojë me kusht në komunën në të cilën ai figuron në LV të komunës përkatëse.

Zyrtari i Identifikimit është përgjegjës për këto detyra:

Zyrtari i identifikimit, skanon kodin e Zarfë të Votimit me Kusht – ZVK, shënon numrin personal, emrin, mbiemrin dhe datën e lindjes të votuesit dhe skanon dokumentin e identifikimit, në platformën elektronike të KQZ;

Zyrtari i të dhënave statistikore, asiston zyrtarin e identifikimit, duke shënuar emrin, mbiemrin e votuesit dhe udhëzon votuesin që të nënshkruaj në Listën e Votuesëve me Kusht – LVK. Pas nënshkrimit, votuesi udhëzohet të kalojë te dhënësi i fletëvotimit;

Nëse votuesi refuzon të nënshkruajë në LVK, nuk do t'i jepet fletëvotimi dhe kryesuesi i VV sigurohet që i njëjti të largohet nga VV dhe rasti evidentohet në librin e votimit;

Dhënësi i fletëvotimit i'a dorëzon fletëvotimin votuesit, ndërsa ZVK i'a dorëzon kryesuesit të VV; Pas votimit, kryesuesi i KVV i'a dorëzon ZVK votuesit, i cili në prani të anëtarëve të KVV dhe vëzhguesve, e vendos fletëvotimin në ZVK e mbyllë atë dhe e vendosë në kutinë e votimit.

#### **Materialet shtesë:**

- Zarfë i votimit me kusht
- Lista e Votuesve me Kusht

## **DHËNËSI I FLETËVOTIMEVE**

Dhënësi i fletëvotimit sqaron mënyrën e votimit, nëse kërkohet nga votuesi, ndan me kujdes fletëvotimin nga numrat amë dhe e vulos në hapësirën e caktuar. Pas ndarjes së fletëvotimit, dhënësi i fletëvotimit bën me ngjyrë matrikuluese në gishtin e madh të dorës së djathtë të të votuesit, përjashtimisht rastet specifike. Pas vendosjes së ngjyrës matrikuluese, votuesit i jepet fletëvotimi dhe udhëzohet të shkojë te njëra nga kabinat e votimit, për të votuar në fshehtësi.

#### **Dhënësi i fletëvotimit, është përgjegjës për:**

- Shënjimën me ngjyrë matrikuluese në gishtin e madh të dorës së djathtë të votuesit;
- Vulosjen e fletëvotimit dhe dhënien e fletëvotimit votuesit;
- Udhëzimin e votuesit për mënyrën e votimit;
- Kontrollimin e fletëvotimeve të papërdorura, në rast se janë në gjendje të rregullt dhe i raporton kryesuesit të VV, nëse ka ndonjë fletëvotim të dëmtuar ose me gabime shtypi;
- Numërimin e amave të fletëvotimeve dhe raportimin tek kryesuesi i VV për fletëvotimet e përdorura dhe të papërdorura;

#### **Materiali i nevojshëm:**

- Fletëvotimet
- Ngjyra matrikuluese
- Vula

## **PROCESIMI I VOTUESIT**

**Hapi 1:** Shënjo gishtin e djathtë tregues të votuesit me ngjyrë matrikuluese.

**Hapi 2:** Shkëput vetëm një fletëvotim njëherësh nga amat e fletëvotimit (të gjitha amat e përdorura të fletëvotimeve duhet të ruhen, sepse numërohen në fund, kur mbyllet vendvotimi.

**Hapi 3:** Kthen fletëvotimin nga prapa dhe e vulos me vule zyrtare në pjesën e epërme të fletëvotimit.

**Hapi 4:** Sqaron dhe udhëzon votuesin për formatin e fletëvotimit dhe si votohet.

**Udhëzimet për votuesin janë:** Informon votuesin se si ta shënojë fletëvotimin

**Hapi 5:** Jep fletëvotimin dhe e drejton votuesin tek kabina e lirë e votimit që të votojë në fshehtësi



### Në raste të jashtëzakonshme


Nëse votuesi nuk e ka gishtin i djathtë tregues të dorës së djathtë spërkateni gishtin e madh, të mesëm të unazës osë gishtin e vogël. Nëse i mungojnë gishterinjët e dorës së djathtë vazhdohet me të njejtën procedurë me dorën e majtë. Nëse votuesi nuk e ka asnjë gisht atëhere hiqet dorë nga procesi i shënimit me ngjyrë matrikuluese dhe votuesi udhëzohet për te kabina e votimit që të voton. Rasti shenohet në librin e votimit nga Kryesuesi


### Fletëvotimet

Rreptësisht ndalohet shkeputja e fletëvotimit të pa vulosur nga Dengu i fletëvotimit, pa prezencën e votuesit.

Rreptësisht ndalohet dalja e Fletëvotimeve nga Vendvotimi dhe Qendra e votimit.

Nëse votuesi e ka dëmtuar fletëvotimin e vet, ai/ajo mund ta dorëzojë fletëvotimin e dëmtuar tek kryesuesi i KVV, i cili e udhëzon tek dhënësi i fletëvotimit, për të marrë fletëvotimin e ri të vulosur. Kryesuesi e tregon para KVV dhe vëzhguesve fletëvotimin e dëmtuar, shkruan në pjesën e prapme të fletëvotimit të dëmtuar fjalën "I DËMTUAR" dhe e vendosë në zarfin për fletëvotime të dëmtuara. Rasti evidentohet në librin e votimit, duke shënuar kohën dhe numrin serik të amës së fletëvotimit.





Votuesi/ja është nënshkruar në LV dhe ndodhet pranë Dhënësit të Fletëvotimeve


Dhënësi i Fletëvotimeve

Vazhdon me gishtin pasues të dorës

Nëse nuk e ka

HAPI 1

Zyrtari Dh.F. i kërkon votuesit gishtin e madh të dorës së djathtë




Nuk vazhdon, udhëzohet të dalë jashtë VV


Votuesi refuzon

HAPI 2

Shënjon me gjyërë martikuluese gishtin



Votuesi Pranon



## **ZYRTARI I TE DHENAVE STATISTIKORE**

Zyrtari i të dhënave statistikore, asiston zyrtarin e identifikimit dhe është përgjegjës për:

- Grumbullimin e të dhënave statistikore të daljes së votuesve, sipas gjinisë dhe grupmoshave; raportimin e të dhënave statistikore te kryesuesi I VV.

Në rastin kur kemi më shumë se pesë (5) anëtarë në një KVV, atëherë:

- Anëtari i gjashtë (6) kryen funksionin e shënjesit të ngjyrës matrikuluese.

- Anëtari i shtatë (7) kryen funksionin e mbikëqyrësit të kutisë së votimit, i cili ka për detyrë të sigurohet që votuesi ta vendosë fletëvotimin në kutinë përkatëse dhe se çdo fletëvotim është i vulosur.



## PËRGATITJET PËR VOTIM

### PARA DITËS SË VOTIMIT

Në këtë kapitull janë përshkruar procedurat dhe detyrat e personelit zgjedhor lidhur me përgatitjet e nevojshme për rregullimin e duhur të Qendrave të votimit dhe vendvotimeve për organizimin e procesit të votimit.

Personeli Zgjedhor obligohet si në vijim:



Komisioni Komunal i Zgjedhjeve siguron dhe mbikqyrë të gjitha përgatitjet zgjedhore në nivel të komunes duke siguruar se personeli zgjedhor i caktuar udhëzohet dhe pranon materialet zgjedhore sipas afateve të përcaktuara në plan e aktiviteteve të aprovuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KKZ).

#### **Menaxheri i QV**

- 1. Vijnë trajnimin përgjegjësit dhe detyrat e menaxherit dhe stafit teknik.**
- 2. Pranon pakon me materiale të QV-së nga Kryesuesi i Vendvotimit.**
- 3. Hap dhe rregullon qendrën e votimit një ditë para Dites së Votimit duke vendos gjitha shenjat dhe udhëzimet për votues.**
- 4. Në bashkëpunim me KKZ-në dhe Policinë, kujdeset për sigurinë e materialit jo të ndjeshëm.**
- 5. Siguron qasjen për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, vendos pjerrina në hyrje dhe dalje**

#### **Kryesuesi i KVV**

- 1. Vijnë trajnimin për procedurat e votimit dhe numërimit.**
- 2. Pranon pakon me materiale të VV-së nga KKZ**
- 3. Hap dhe rregullon vendvotimin një ditë para Dites së Votimit duke vendos gjitha shenjat dhe udhëzimet për votues.**

## Materialet e Zgjedhjeve dhe Shpërndarja e tyre

Komisioni Komunal i Zgjedhjeve është i obliguar dhe përgjegjës për shpërndarjen e materialeve jo të ndjeshme për personelin zgjedhor (Menaxherve dhe Kryesuesve të VV). Kjo duhet të bëhet në mënyrë transparente duke evidentuar çdo material që dorëzohet/pranohet në formular zyrtar për pranim/dorëzim. Çdo material që dorëzohet/pranohet duhet të kontrollohet/testohet paraprakisht bashkarisht në mes Kryesusit dhe KKZ. Çdo vërrejtje/mungesë apo mos-funksionim i materialit raportohet tek KKZ.

Materialet e zgjedhjeve ndahen në dy grupe, të ndjeshme dhe jo të ndjeshme. Materialet shpërndahen sipas planit të aktiviteteve dhe udhëzimeve të KQZ.

## MATERIALET PËR VENDVOTIM

Tabela në vijim ilustron llojet e materialeve që do të përdoren nga KVV në vendvotim. Kryesuesi është përgjegjës para pranimit të kontrollon/teston të gjitha materialet dhe të nënshkruaj në formular.

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republika of Kosovo  
Kosovo Election System / Zgjedhjet  
Zjedhshme Evropiane / European  
Union / Evropski izbori

**Formulari i dorëzimit të materialit  
Obrazac za primopredaju materijala**

Me këtë vërtetoj se kam marrë / Ovim potvrđujem da sam primio/a

1. Numri i fletëve/mëve Broj glasovačkih listica	<input type="text"/>	
2. Lista e votuesve me Birački spisak sa	<input type="text"/>	faqe strane
3. Vula Pečat za glasačke listice	<input type="checkbox"/>	Da Ne
4. Lapsi matricular Matricularna boja	<input type="checkbox"/>	Da Ne
5. Kamera regjistruese Kamera za snimanje	<input type="checkbox"/>	Da Ne
		Numri serik Serijski broj _____
6. Për vendvotimin numër za broj biračkog mesta	<input type="text"/>	/ <input type="text"/>
7. Dhe konfirmoj se i kam kontrolluar dhe marrë të gjitha materialet jo të ndjeshme i potvrđujem da sam proverio i dobio sav neosetljivi materijal		<input type="checkbox"/> Da Ne

Kryesuesi i kështjtit të vendvotimit ose zëvendës kryesuesi,  
Predsedavajući biračkog odbora ili zamenik predsedavajućeg

8. Emri dhe mbiemri  
Ime i prezime \_\_\_\_\_

9. Nënshtkrimi  
Potpis \_\_\_\_\_



Amëtar i KKZ së  
Član O.K.Z. a \_\_\_\_\_

10. Emri dhe mbiemri  
Ime i prezime \_\_\_\_\_

11. Nënshtkrimi  
Potpis \_\_\_\_\_

Formulari për Dorëzim-Pranim

## MATERIALET

Shpërndarja	Jo të ndjeshme	Të Ndjeshme
 <b>Para Zgjedhjeve (-1 ditë)</b>	<p><b>Vendvotim i rregullt:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Lidhëset e sigurisë</li> <li>✓ Libri i votimit</li> <li>✓ Formulari i Rezultateve (FR) Ngjyra dhe mbushësit</li> <li>✓ Kabinat e votimit</li> <li>✓ Kutia e votimit</li> <li>✓ Formular për ankesa në PZAP</li> <li>✓</li> </ul> <p><b>Vendvotim me kusht:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Libri i votimit</li> <li>✓ Formulari i votimit me kusht (FVK)</li> <li>✓ Ngjyra dhe mbushësit</li> <li>✓ Jastëku i vulës</li> <li>✓ Kabinat e votimit</li> <li>✓ Kutia e votimit</li> <li>✓ Zarfi Fletvotimit me Kusht (ZFK)</li> </ul>	
 <b>Në Ditën e Zgjedhjeve</b>		<p>Kryesuesi pranon në mengjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Fletëvotimet</li> <li>✓ Lista e votuesve (LV)</li> <li>✓ Vula</li> <li>✓ Ngjyra matrikuluese</li> <li>✓ Kamera regjistruese</li> </ul> <p>Kryesuesi transporton në KKZ:</p> <p>Zarfi i KKZ</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ LV</li> <li>✓ FR</li> <li>✓ Libri i Votimit</li> <li>✓ Lidhëset e sigurisë</li> <li>✓ Kutia votimit</li> <li>✓ Thesi 2 dhe 4</li> <li>✓ Zarfi 1 dhe 3</li> <li>✓ Vula</li> <li>✓ Kamera regjistruese</li> <li>✓ Thesi me material administrativ</li> </ul>

## MATERIALET PËR QENDËR TË VOTIMIT

Tabela në vijim ilustron llojet e materialeve që do të përdoren nga Menaxherët dhe personeli teknik i Qendrës së Votimit. Menaxheri i QV është përgjegjës para pranimi të kontrollojnë/teston të gjitha materialet dhe të nënshkruaj në formular.

MATERIALET		
Shpërndarja	Jo të ndjeshme	Të Ndjeshme
<b>Para Zgjedhjeve (-1 ditë)</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Lista e gjërë Komunale</li><li>✓ Shabllon të "Brail" për votim të personave të verbër</li><li>✓ Shenja dhe poster informues</li><li>✓ Material administrative (lapsa, marker, letër dhe ngjitës)</li><li>✓ Formular për ankesa në PZAP</li></ul>	
<b>Në Ditën e Zgjedhjeve</b>	Bashkë me personelin teknik organizojnë dhe mbledhin tërë materialin zgjedhor jo të ndjeshëm dhe e përgatisin për ta transportuar në KKZ.	

## RREGULLIMI I QENDRAVE TË VOTIMIT DHE VENDVOTIMEVE





## **Rregullimi i Vendvotimit**

Kryesuesi i KVV, bashkë me anëtarët e KVV, është përgjegjës për pranimin, mirëmbajtjen dhe kthimin e materialit zgjedhor të ndjeshëm dhe jo të ndjeshëm, të cilin e ka pranuar nga KKZ.

### **Si rregullohet vendvotimi**

- Largohet çfardo material i fushates zgjedhore;
- Organizon tavolinat për të mundësuar qarkullim sa më efikas të votuesve gjatë votimit;  
*Ulëset duhet të rregullohen në atë mënyrë që anëtarët e KVV-së, vëzhguesit e zgjedhjeve dhe përfaqësuesit e akredituar të mediave të mund ta shikojnë tërë procesin e votimit dhe t'i shohin qartë kutitë e votimit gjatë gjithë kohës.*

**Vëmendje: Vëzhguesit duhet të ulen prapa tavolinave të zyrtarëve të KVV (shih foton)**

**Shenjat duhet të vendosen në vende praktike për votues, me qëllim t'ju shërbejnë atyre për informim dhe edukim në Ditën e votimit. (Shih foton me ilustrimin e VV, faqe 28)**

### **Vendosja e shenjave dhe e njoftimeve në vendvotim**

#### **Brenda vendvotimit:**

- Shenjat e shigjetave për orientim (brenda VV-së).
- Vendosen kabinat e votimit në dy kende të hapësirës, në mënyrë që të sigurohet që votuesi mund të votojë në fshehtësi.
- Përgatitet/përshtatet një kabinë votimi më të ultë për të mundësuar votim të fshehtë për personat/votuesit në karrocë
- Shenja për ndalimin e konsumimit të alkoolit, poster me listën e ndalesave që përfshijnë: ndalimin e armëmbajtjes, fotografimin e votës, votimin familjar.


**Vëmendje: Vendosja e kamerave vëzhguese në hapësirat brenda vendvotimit bëhet me qëllim të garantimit të sigurisë së materialeve të ndjeshme dhe ruajtjes së integritetit të procesit të votimit dhe numërimit, në vendvotim.**

#### **Jashtë vendvotimit:**

Njoftimet e mëposhtme duhet të ekspozohen kryesisht jashtë vendvotimit:

- Vendos mbi derë ose në hyrje të vendvotimit shkronjat e alfabetit të mbiemrave të votuesve të caktuar të votojnë në atë vendvotim. (p.sh. vendvotimi 1901/01 A-D) d.m.th. të gjithë votuesit të cilëve mbiemri iu fillon me A deri në D, votojnë këtu.
- Posterët "Si të shënohet fletëvotimi" (Në kabinë të votimit dhe jashtë VV-ve).
- Shenjat për "ndalimin e pirjes së duhanit" (jashtë VV-së).
- Shenja për "ndalimin e publikimit- ekspozimit të Fletëvotimit të votuar"  
poster me listën e ndalesave, që përfshijnë: ndalimin e armëmbajtjes, fotografimin e votës, votimin familjar.

# VENDVOTIMI





DITA E VOTIMIT

## NË DITËN E VOTIMIT

Në Ditën e votimit qendrat e votimit dhe vendvotimet duhet të jenë të përgatitura dhe gatshme për tu hapur në orën e përcaktuar zyrtarisht nga KQZ.


- KKZ është përgjegjës për shpërndarjen e materialeve të ndjeshme Kryesuesve të vendvotimeve.

- Menaxherët e qendrave janë përgjegjës për rregullimin e qarkullimit brenda QV, si dhe udhëzimin e votesve brenda qendres për vendndodhjen e VV.


- Kryesuesit e VV janë përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të votimit brenda në vendvotim, duke siguruar proces të qetë përmes respektimit të drejtave të votuesve dhe akterëve tjerë të përfshirë në proces. Kryesuesi obligohet që deri në orën: 06:00 ta kenë pranuar dhe kontrolluar materialin e ndjeshëm dhe të nevojshëm për mbarëvajtjen e procesit të votimit. Anëtarët tjerë të KVV janë të obliguar të paraqiten në vende të punës në mëngjes në orën: 06:00.

### 05:00-06:00 në mëngjes:

1. Kryesuesi kontrollon, verifikon dhe pranon materialin e ndjeshëm nga KKZ dhe siguron që asgjë nuk mungon
2. Nënshkruan formularin e KKZ për pranim të materialeve
3. Në përçellje të policisë transporton materialin në vendvotim.
4. Kryesuesi vendos kamerat regjistruese sipas udhëzimeve të pranuar nga KQZ.



### 06:00 - 07:00



1. Të gjithë anëtarët e KVV duhet të jenë prezent në vendvotimin e tyre në ora 06:00 të mëngjesit.
  2. Pranojnë materialet nga Kryesuesi
  3. Rregullojnë vendvotimin sipas udhëzimeve nga procedurat.
  4. Vendosin stikersat me kodet e vendvotimit dhe kutisë së votimit të shtypura paraprakisht.
  5. Kryesuesi siguron se anëtarët i din detyrat dhe përgjegjësitë e tyre
- NËSE: mungon materiali zgjedhor ose ndonjë anëtar i KVV - informo KKZ-në.

## 07:00-deri në mbyllje të QV

1. Hap QV me kohë dhe delegon detyrat te personeli teknik
2. Siguron se shenjat orientuese dhe udhëzimet për votues janë vendosur në vende praktike
3. Rregullon tavolinën ndihmëse
4. Raporton në KKZ: Mungesat e stafit ose materialit; hapjen/mbylljen e QV/VV; daljen e votuesve për të votuar.



### HAPJA E VENDVOTIMIT

VV hapet dhe funksionon me pjesëmarrjen e plotë të KVV, prej pesë (5) anëtarë. Përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, në raste të mungesës së anëtarëve të KVV, KKZ me vendim mund të lejohet hapjen dhe funksionimin e VV me së paku tre (3) anëtarë të KVV.

Kryesuesi duhet t'i kryej këto detyra para se ta hap vendvotimin zyrtarisht:

#### **Plotëson në fletë të punës të FR-së:**

- Plotëson pjesën e parë: shkruan numrin e VV; numrat e shiritave për mbylljen e kapakut të kutisë së votimit. Shih mostrat e FR-së.
- Verifikon dhe plotëson numrin total të fletëvotimeve të pranuar

#### **Shkruan në Libër të votimit:**

- emrat dhe numrat personal të letërnjoftimeve të të gjithë anëtarëve të KVV-së;
- emrat, mbiemrat dhe numrat personal të letërnjoftimeve dhe numrat e akreditimit (distinktivëve të vëzhguesve) të të gjithë vëzhguesve të akredituar të pranishëm.

#### **Udhëzon KVV dhe vëzhguesit**

- Udhëzon KVV të marrin materialet e nevojshme dhe të përgatiten për të filluar.
- Vëzhguesve u rikujton obligimet dhe të drejtat e tyre si vëzhgues

#### **Demonstron të pranishmive:**

- Tregon kutinë e zbrazët të votimit në prani të anëtarëve të KVV-ve dhe të gjithëve që janë të pranishëm në vendvotim.
- Mbyll kutinë me shiritat mbyllës dhe të shënon numrat serik në FR të pjesa përkatëse, nëse vec nuk janë shënuar në hapin paraprak.

Pas këtyre hapave dhe demonstrimeve Kryesuesi i KVV-së shpall hapjen e Vendvotimit dhe fillimin e procesit të votimit.

Orët e votimit janë: 07:00-19:00

### PARA SE TË VOTON VOTUESI PARË

Kryesuesi dhe anëtarët e KVV-së mund të votojnë të parët, mirpo vetëm pasi të hapet vendvotimi zyrtarisht, pra jo me heret se ora 7:00 (Kryesuesi lejon që vetëm një anëtar i KVV të dal dhe votojë si i rregullt, nëse anëtarët e KVV nuk janë duke shërbyer në QV e tyre.

# PROCESI I VOTIMIT (07:00-19:00)

## PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E VOTIMIT

Kategoritë e votimit

Ligji për zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës lejon këto kategori të votimit

- 1) Votim të rregullt; 2) Votim me kusht; 3) Votim jashtë vendit - me postë (me kusht)
- 4) Votim për persona me nevoja dhe rethana të veçanta (me kusht)

### VOTIMI I RREGULLT

#### VOTUESI

#### PERSONELI ZGJEDHOR (KVV)

Votuesi/ja hyn në vendvotim dhe tregon duart për ekzaminim

HAPI

1

Kontrolluesi/ja e rreshtit kontrollon nëse votuesi/ja ka votuar më herët, duke ekzaminuar duart e votuesit nëse ka njolle të ngjyres matrikuluese.

Votuesi/ja jep gishtin e djathtë tregues për t'iu shënjuar me ngjyrë matrikuluese, si dhe merr fletëvotimin

HAPI

2

Dhënësi i Fletëvotimeve e bene me ngjyre matrikuluese gishtin e madh të dorës së djathtë, e vulos fletëvotimin në hapsirën e caktuar dhe ja jep votuesit/es.

Votuesi/ja shkon në kabinën e zbrazët të votimit për të votuar fshehtas.  
Pasi të ketë votuar ai/ajo palos fletëvotimin dy herë, e vendos në kutinë e votave dhe del nga aty

HAPI

3

Mbikqyrësi i kutisë së votave kontrollon me sy a është fletëvotimi i vulosur, hap kutinë që votuesi personalisht të hedh votën në kuti.

VOTUESI

PERSONELI  
ZGJEDHOR (KVV)

Votuesi/ja hyn në VV të duhur dhe tregon duart për ekzaminim

HAPI  
**1**

Kontrolluesi/ja e rreshtit kontrollon nëse votuesi/ja ka votuar më herët, duke ekzaminuar duart e votuesit nese ka njolle te ngjyres matrikuluese.

Votuesi/ja tregon dokumentin identifikues para zyrtarit/es të identifikimit

HAPI  
**2**

Zyrtari/ja e identifikimit gjen votuesin/en në Listen e Votuesve (LV), verifikon informatat dhe kërkon nga votuesi/ja të nënshkruhet në LV. Nëse votuesi/ja nuk gjindet në LV, orientohet tek tavolina ndihmëse.

Votuesi duhet të ketë dokument të pranueshëm identifikues, në të kundërtën nuk lejohet të votoj

Votuesi nënshkruan LVK dhe ZFK  
Nëse jo, nuk vazhdon.

HAPI  
**3**

Zyrtari i identifikimit skanon kodin e ZVK-se, shenon të dhënat personale dhe skanon ID-ne ne platformen elektronike te KQZ-se. Zyrtari i te dhenave statistikore shenon të dhënat e votuesit dhe udhëzon që të nënshkruaj ne LVK të votuesit dhe e udhëzon të nënshkruhet.

Votuesi/ja jep gishtin e djathtë tregues për t'iu shënjuar me ngjyrë matrikuluese

HAPI  
**4**

Ja dorëzon dokumentin e identifikimit votuesit dhe ZVK-në Kryesuesit  
Dhënësi i Fletëvotimeve e bene me ngjyre matrikuluese s gishtin e madh të dorës së djathtë, e vulos fletëvotimin në hapsiren e caktuar dhe ja jep votuesit/es.

Votuesi/ja shkon në kabinën e zbrazët të votimit për të votuar fshehtas. Pasi të ketë votuar ai/ajo palos fletëvotimin dhe e vendos në zarf të fshehtësisë dhe më pas në ZFK; e mbyll zarfin dhe e hedh personalisht në kutinë e votave dhe del nga aty

HAPI  
**5**

Mbikqyrësi i kutisë së votave kontrollon me sy a është fletëvotimi i vulosur; Jep ZFK votuesit, hap kutinë që votuesi personalisht të hedh voten në kuti. Në fund ia kthen dokumentin identifikues votuesit.

## **Votimi me Kusht**

Votimi me kusht dallon nga votimi i rregullt, sepse votat nuk numrohen në vendvotim, por në Qendër të Numërimit . Formati i votimit përvec procedurave të rregullta, i ka disa procedura shtesë ngase kërkon skanon kodin e Zarfit të Votimit me Kusht – ZVK, shënon numrin personal, emrin, mbiemrin dhe datën e lindjes të votuesit dhe skanon dokumentin e identifikimit, në platformën elektronike të KQZ, dhe të shkruhen të dhënat personale të votuesit dhe nenshkrimin në listen e votuesve me kusht (LVK). ZVK hidhet në kutinë e votave me kusht .

Votuesit votojnë me kusht në rastet kur për ndonjë arsye ata nuk plotësojnë kriteret e zotësisë juridike. Arsyet pse votuesi voton me kusht janë:

- a) Votuesi në Kosovë, emri dhe mbiemri i të cilit gjendet në LV, i cili për arsye objektive nuk mund të votojë në vendvotimin e tij/saj i lejohet të votojë në QV me kusht në cilëndo komunë për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.
- b) Në zgjedhjet lokale, votuesit i lejohet të votojë me kusht në komunën në të cilën ai figuron në LV të komunës përkatëse.

### **Mohimi i votimit me kusht (Rastet kur nuk duhet lejuar të votojnë me kusht)**

- a) Është evidente prania e njolles së ngjyrës matrikuluese
- b) Votuesi refuzon t'i bëhet gishti me ngjyrë matrikuluese
- c) Votuesi nuk ka DI të pranueshem.

## **Votimi me asistencë**

Votuesi i cili është me aftësi të kufizuara në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedh fletëvotimin, kur aftësia e tij e kufizuar dëshmohet përmes dokumenteve përkatëse, mund të ndihmohet nga një person tjetër (asistuesi) nga e njëjta QV, i zgjedhur nga votuesi, duke ndjekur procedurën e mëposhtme:

Personi që asiston duhet të jetë i moshës 18 vjeç dhe të ketë një nga dokumentet e identifikimit të Republikës së Kosovës.

- asistuesi e ndihmon vetëm një votues dhe nuk është anëtar i KVV ose vëzhgues i akredituar;

- në rastin kur personi i asistuar nuk është në gjendje fizike të nënshkruaj atëherë asistuesi shkruan në LV “PËR: emrin dhe mbiemrin e tij”, në hapsirën e votuesit që është asistuar;

- kryesuesi i KVV shënon në Librin e Votimit numrin rendor, kohën, të dhënat personale të votuesit dhe të asistuesit si dhe arsyen e saktë të votimit me asistencë. Numri i rastit në Librin e Votimit shënohet në hapësirën e votuesit në LV;

- Asistuesi mund ta ndihmojë në votim personin me aftësi të kufizuara, duke ia mbajtur dorën dhe mundësur që votuesi të shënoj vetë fletvotimin. Në rast se votuesi nuk mund ta hedhë fletëvotimin në kuti, atëherë asistuesi e ndihmon këtë proces.



# IV MBYLLJA E VENDORVOTIMIT

## MBYLLJA E QENDRËS SË VOTIMIT

QV mbyllen në orën 19:00. Çdo person që gjendet në radhë brenda QV në momentin e mbylljes, i lejohe të votojë. Menaxheri i QV dhe kryesuesi i VV, sigurojnë që të gjithë ata që janë në radhë brenda QV, hyjnë në VV. Personi që vjen pas mbylljes së QV, nuk mund të votojë.

## MBYLLJA E VENDORVOTIMIT (19:00)

Kryesuesi i KVV-së është përgjegjës për mbylljen e vendvotimit në orën e përcaktuar zyrtarisht nga KQZ (19:00). Kryesuesi i KVV bashkë me anëtarët tjerë të KVV janë përgjegjës për këto detyra:

### Detyrat e menjëhershme:

1. Kryesuesi shikon jashtë vendvotimit a ka votues dhe konsultohet me Menaxherin e QV për të kuptuar a ka votues brenda në QV.
  2. Nëse Menaxheri konfirmon se nuk ka votues, Kryesuesi udhëzon Kontrolluesin e rreshtit ta mbyll derën dhe shpall vendvotimin zyrtarisht të mbyllur.
- Mbyll vrimen e kapakut të kutisë së votimit me shirit mbyllës dhe e shkruan numrin e shiritit në Formular të rezultateve (FR) dhe në libër të votimit.
  - Shkruan në librin e votimit kohën e mbylljes së vendvotimit dhe emrat e personave të pranishëm në vendvotim dhe i informon se nëse largohen nga VV-ja para se të përfundojë numërimi, ata nuk do të lejohen të kthehen-(pos anetareve të KVV-së për nevoja fiziologjike).

### **Detyrat para se të hapet kutia e votave**

Para fillimit të numërimit, kryesuesi udhëzon anëtarët e KVV, që të:

Vendosin vulën dhe ngjyrën matkuluese në një thes plastik, që mbyllet me shiritin e sigurisë, numrat e të cilit shënohen në librin e votimit;

largojnë lapsat që janë përdorur gjatë procesit të votimit dhe materialet tjera që nuk nevojiten për numërim, të cilat vendosen në thes plastik, që mbyllet me shiritin e sigurisë, numrat e të cilit shënohen në librin e votimit;

organizojnë hapësirën e numërimit në atë mënyrë që, mundëson numërimin efikas për anëtarët e KVV dhe në mënyrë transparente për vëzhguesit, të përcaktuar sipas procedurës;

shpërndajnë lapsat dhe materiale tjera të dedikuara për numërim, si: Formularin e përputhjes së rezultateve, notesin dhe materiale tjera administrative, të përcaktuara sipas procedurës.

Pas përgatitjeve teknike për numërim, kryesuesi sigurohet që në rast se në VV ka më shumë se një kuti të votimit, kutia e radhës të hapet pas përfundimit të procesit të numërimit dhe mbyllet të kutsisë paraprake

### **6. Përgatitjet për numërim të votave:**

Vendosni tavolinat në forme të shkronjes "T" në atë mënyrë që vëzhguesit e akredituar të mund të shohin qartë tërë procesin e numërimit.

Kryesuesi ndan detyrat për anëtarët e KVV, si në vijim:

Dhënësi i fletëvotimit, i ndihmuar nga një anëtar i KVV, llogaritë numrin e nënshkrimeve në LV, ndërsa kryesuesi shkruan numrin e tyre në FR. Gjatë këtij procesi, asnjë veprim tjetër nuk mund të zhvillohet në të njëjtën kohë.

Zyrtari i identifikimit, i ndihmuar nga një anëtar i KVV, evidenton dhe numëron:

- Fletëvotimet e mbetura të papërdorura;
- numrat amë të fletëvotimeve të përdorura;
- fletëvotimet e dëmtuara dhe i vendosin ato prapë në zarfin e caktuar për fletëvotime të dëmtuara.

Kryesuesi i KVV sigurohet që rezultatet e pranuar t'i shënojë në FR.



# NUMËRIMI I FLETËVOTIMEVE DHE PËRPUTHJA E REZULTATEVE

## HYRJE NË PROCEDURË TË NUMËRIMIT TË VOTAVE

Gjatë hapjes së kutisë, kryesuesi i KVV cakton njërin prej anëtarëve të KVV që të heqë shiritat mbyllës dhe hapë kutinë e votimit. Shiritat vendosen në thesin përkatës, i cili në fund të procesit mbyllet me shirit të sigurisë.

Kryesuesi cakton një anëtar të KVV të hap kutinë e votimit dhe të nxjerrë fletëvotimet, duke u siguruar që asnjë fletëvotim të mos mbetet brenda asaj kutie të votimit.

### Vlefshmëria e fletëvotimit dhe votës

#### Fletëvotimi konsiderohet i vlefshëm nëse:

Është i vulosur; Ka numrin serik të VV përkatës; Vota është e vlefshme, kur votohet vetëm një opSION dhe kuptohet qartë qëllimi i votuesit; Për procesin e votimit, votë e vlefshme konsiderohet atëherë kur votuesi e ka shënjuar vetëm një opSION në fletëvotim.


#### Vota është e pavlefshme nëse:

Votohet më shumë se një opSION; nuk votohet asnjë opSION; qëllimi i votuesit nuk është i qartë, sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim.

Nëse anëtarët e KVV nuk arrijnë të pajtohen lidhur me atë se a është vota e vlefshme apo i pavlefshme, atëherë kryesuesi merr vendimin përfundimtar përkitazi me atë votë dhe këtë rast e evidenton në librin e votimit.


Anëtarët e tjerë të KVV dhe vëzhguesit e pranishëm në VV, kanë të drejtë të mbajnë shënime për numërimin dhe në rast të gabimeve gjatë numërimit, të tërheqin vërejtjen.

### Përputhja 1:



Numri total i nënshkrimeve në LV

=



Numri total i fletëvotimeve brenda në kuti të votave

### Përputhja 2:



Numri total i fletëvotimeve brenda në kuti të votave

+



Numri total i fletëvotimeve të papërdorura

+




Numri total i fletëvotimeve të dëmtuara

=



Numri total i fletëvotimeve të pranuar (dorëzuar nga KKZ)

### Përputhja 3:



### NUMËRIMI I ZARFEVE ME KUSHT

Pas mbylljes së VV me kusht, KVV numëron nënshkrimet në LVK dhe në regjistrin elektronik të votuesve.

Në rast të mospërputhjes, kryesuesi i VV me Kusht evidenton këtë në Shtojcën VI – FVK – Formulari i Votimit me Kusht dhe në librin e votimit.

Pas numërimit të nënshkrimit KVV zbaton procedurat për hapjen e kutisë sipas nenit 15 të Rregullores 12/2024, duke iu përshtatur numërimit të Vendvotimit me Kusht. Detajet e këtij procesi parashihen me Procedurën për Votim dhe Numërim në Vendvotim.

Kryesuesi cakton një anëtar të KVV të hap kutinë e votimit dhe të nxjerrë zarfet e fletëvotimit me kusht (ZFK), duke u siguruar që asnjë ZFK të mos mbetet brenda asaj kutie të votimit.

Kryesuesi cakton dy anëtarë të KVVK-së për numërimin e ZFK-ve. Kryesuesi sigurohet që numërimi të bëhet dy herë.

Plotëson Formularin e Votimit me Kusht (FVK). Në rast të mospërputhjes së nënshkrimeve në LVK dhe numërimit të ZFK, Kryesuesi evidenton këtë në FVK dhe në librin e votimit.

Pas përfundimit të numërimit dhe evidentimit:


Zarfet e numëruara i vendosë në kuti;

Mbyllë kutinë me shirita të sigurisë dhe evidenton në FVK.



Numri total i nënshkrimeve në LVK

=



Shumën totale të ZFK brenda në kuti

## NUMËRIMI I VOTAVE

Kryesuesi bashkë me anëtarët tjerë të KVV janë përgjegjës për këto detyra:

### Hapi 1:

- Përgatit tavolinat dhe hapsirën ku do të numërohen votat duke lënë qasje për vëzhguesit
- Largon lapsat dhe gjërat tjera nga tavolina numërimit
- Kryesuesi vendos personelin e KVV në pozitat e tyre
- Sjell kutinë e votave mbi tavolinë dhe lexon numrat e shiritave të sigurisë dhe i krahason me numrat e shkruar në FR ose në libër të votimit.

### Hapi 2:

- Kryesuesi i KVV cakton njërin prej anëtarëve të KVV që të heqë shiritat mbyllës dhe hapë kutinë e votimit
- Zbraz fletëvotimet mbi tavolinë dhe i klasifikon në: të vulosura dhe të pavulusora;
- Fletëvotimet e pavulusura ndahen dhe evidentohen si vota të pavlefshme;
- Kthejnë fletëvotimet e vulosura mbarë dhe klasifikojnë fletëvotimet në të vlefshme dhe të pavlefshme;
- ndajnë fletëvotimet e vlefshme;
- pas ndarjes së fletëvotimeve, numërohen votat për secilin opcion (po dhe jo) veç e veç dhe ndahen sipas dengjeve (me nga 50 fletëvotime);
- fletëvotimet rinumërohen, për të vërtetuar nëse ka çfarëdo mospërputhje midis numrit të fletëvotimeve në kuti dhe numrit të nënshkrimeve në LV;
- Kryesuesi mbledhë numrin apo shumën totale të fletëvotimeve dhe e shkruan në formular të rezultateve përkatës (FR).

### Hapi 3:


Kryesuesi krahason shumën totale të nënshkrimeve në LV, të shkruar në FR me shumën totale të fletëvotimeve në kuti të votave (Përputhja 1)

Nëse ka mospërputhje, pranohet toleranca e mospërputhjes si në vijim:

- Deri në 100 nënshkrime në LV, tolerohet mospërputhje 1 (+/-)
- Deri në 200 nënshkrime në LV, tolerohet mospërputhje 2 (+/-)
- Më shumë se 200 nënshkrime në LV, tolerohet mospërputhje 3 (+/-)

### Hapi 4:

Kthen fletëvotimet mbarë dhe i klasifikon në:




### Hapi 5:

- Ndaj fletëvotimet sipas opsionit;
- Merr dengun e fletëvotimeve të Opsionit po dhe numroj votat e fiturara;
- Merr dengun e fletëvotimeve të Opsionit Jo dhe numroj votat e fiturara;
- Numero çdo deng dy herë përmes dy anëtarëve të ndryshëm të KVV-së për të vërtetuar saktësinë.

**Shënim:** Nëse nga dy numrimet, shuma e votave është e njëjtë, vazhdohet me dengun e radhës. Ndërsa nëse shuma nuk përputhet, atëherë dengu rinumrohet përsëri.

- Procesi vazhdon deri kur numërohen të gjitha fletëvotimet
- Votat e numëruara shënohen nga kryesuesi i KVV në (FR);
- Kryesuesi kontrollon të dhënat dhe sigurohet se është arritur përputhja;
- Paketën materiale sipas udhëzimeve, por nuk i mbyll në këtë fazë



## VI FORMULARËT E REZULTATEVE

Pas përfundimit të numërimit të votave, Kryesuesi i KVV i shkruan rezultatet e votave në Formular të rezultateve.

Formulari që përdoret për regjistrimin e rezultateve është:

Formulari I Rezultateve (FR)

- Kryesuesi kopjen e pembe të formularit e shkëput dhe vendos në ambient për publik
- Kopjen e verdhë të Formularit ia dorëzon personelit për futjen e rezultateve preliminare

Plotësimi i Formularve

- Çdo formular përmban një fletë pune. Kryesuesi gjatë procesit të numërimit do të shkruan në fletë pune dhe vetëm kur vërteton se të dhënat janë saktë, i bart në FR origjinale.
- Lejon vëzhguesit e akredituar të pranishëm të marrin informata nga FR nëse e kërkojnë një gjë të tillë;
- Publikon kopjen e FR-se apo FVK në hyrje të QV.

**KUJDES: FALSIFIKIMI, MANIPULIMI I VOTAVE GJATË NUMËRIMIT/REGJISTRIMIT NË FORMULAR TË REZULTATEVE PARAQET SHKELJE TË RËNDË / VEPËR PENALE DHE MUND TË DËNOHET ME BURGIM NGA 3 DERI NË 5 VITE.**

### SI TË PLOTËSOHET FORMULARI I REZULTATEVE FR

#### Pjesa 1. Para hapjes së Vendvotimit

1. Shënohet numri i Vendvotimit
2. Shëno numrat e shiritave të kapakut mbyllës të kutisë
3. Plotëso numrin e fletëvotimeve të pranuar

#### Pjesa 2. Para hapjes së kutisë

4. Shënohet numri i shiritit për mbylljen e vrimës së kapakut të kutisë së votimit;
5. Shënohet numri i nenshkrimeve në Listën e Votuesve (LV);
6. Shënohet numri i fletëvotimeve të papërdorura;
7. Shëno numrin e fletëvotimeve të dëmtuar gjatë ditës.

### Pjesa 3. Pas hapjes së kutisë së votimit

8. Shënohet numri i fletëvotimeve brenda kutisë së votimit;
9. Shënohet dallimi në mes numrit të nënshkrimeve në Listën Votuese (LV) dhe fletëvotimeve brenda kutisë së votimit rubrika 5 dhe 8;
10. Shënohet numri i fletëvotimeve të zbrazëta, të paplotësuara dhe të pavlefshme (brenda kutisë);
11. Shënohet numrin e fletëvotimeve të vlefshme;
12. Shënohet numri i gjithsejt i Fletëvotimeve të paplotësuara, të pavlefshme dhe të vlefshme pra rubrika 10+11;
13. Të mbledhen numri i fletëvotimeve të papërdorura (rubrika 6), numrin e fletëvotimeve të cilat janë dëmtuar gjatë ditës (rubrika 7) dhe numrin e fletëvotimeve të paplotësuara, të pavlefshme dhe të vlefshme (rubrika 12) ose (6+7+12);
14. Të shënohet dallimin në mes të numrit të fletëvotimeve të pranuar dhe numrit të e fletëvotimeve të papërdorura, numrin e fletëvotimeve të cilat janë dëmtuar gjatë ditës dhe numrin e fletëvotimeve të paplotësuara, të pavlefshme dhe të vlefshme pra rubrika 3 +13.
15. Të shënohen gjithsej votat e vlefshme (rubrika 11)

### Pjesa 4. Pas numërimit / Paketimi

Të rregullohet kutia e votimi sipas diagramit të paketimit dhe të shënohen numrat e shiritave mbyllës të kutisë së votimit.

- Numri i shiritit mbyllës të thesit 2 dhe
- Numri i shiritit mbyllës të thesit 4

### Pjesa 5. Këshilli i Vendvotimit - Nënshkrimi i anëtarëve të Këshillit të Vendvotimit

**SHEMBUJT E FORMULARËVE I GJENI TEK SHTOJCAT NË FUND TË DOKUMENTIT**



# VII

## PAKETIMI

### PAKETIMI NË VENDVOTIM TË RREGULLT

Kryesuesi bashkë me anëtarët tjerë të KVV janë përgjegjës për paktimin e materialeve zgjedhore sipas procedurave zyrtare dhe diagramit të paketimit që ndodhet në shtojcë, si dhe është i shtypur në kopertinën e FR.

#### Hapi 1:

- Nxjerr diagramin e paketimit që mund të jetë i shtypur në kopertinën prapa FR dhe në Doracak të procedurave.
- Bën gati të gjitha zarfet, thasët dhe kutinë e votimit, spangon
- Shkruan kodin/numrin e vendvotimit në çdo zarf/thes apo tiketë (p.sh. 1901/01)

#### Hapi 2:

- Vendos materialet zgjedhore sipas udhëzimeve në Diagram të paketimit (nuk i mbyll njëherë)
- Në çdo tiketë të zarfit apo thesit shkruan shumën apo sasinë e fletëvotimeve brenda.
- Shkruan numrat e shiritave mbyllës në FR për thasët (#2 dhe #4) të cilët mbyllën me shirit
- Shkruan numrat e shiritave mbyllës në FR për mbylljen e kapakut të kutisë së votave.
- Fletëvotimet e përdorura, sidomos ato të vlefshme sipas lidhen me spango dhe futen në thes.
- Para se ti mbyll zarfet/thaset apo kutinë kontrollon dhe verteton se paketimi është bërë sipas udhëzimeve në diagram.
- Kontrollon a janë nënshkruar të gjithë anëtarët e KVV në FR.

#### Hapi 3:

- Mbyll zarfet, thasët dhe kutinë e votave dhe i bënë gati për transport
- Paketon materialin jo të ndjeshëm në një thes.

#### Hapi 4:

- Kryesuesi së bashku me një anëtar të KVV nga subjekti i kundërt politik është përgjegjës për dërgimin e materialit zgjedhor në Deponi Kumunale.

**Shënim:** Nëse paketimi bëhet sipas udhëzimeve, pranimi/dorëzimi i materialeve në KKZ do të shkojë me lehtësi. Në të kundërtën Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) mban të drejtën të urdhëroj Kryesuesin që ti ri-paketoj në materialet ne Depo.



## PAKETIMI – NË VENDVOTIM ME KUSHT

Kryesuesi bashkë me anëtarët tjerë të KVV janë përgjegjës për paktimin e materialeve zgjedhore sipas procedurave zyrtare dhe diagramit të paketimit.

### Hapi 1:

- Paketohen materialet sipas procedurave

### Hapi 2:

- Zarfet e numeruara i vendosë në kuti dhe shkruan shiritin mbyllës në FVK;
- Në zarfin për KKZ, Paketon artikujt si në vijim: Listën e Votuesve me Kusht (LVK), FVK dhe Librin e votimit;
- Në kutin e votimit janë: ZVK, Vula dhe Lapsi matrikulues;


Pas përfundimit të materialeve të ndjeshme si në VV e rregullta ashtu edhe ato me kusht, Kryesuesi është përgjegjës për mbledhjen e materialeve jo të ndjeshme nga vendvotimet për t'i dërguar në depot e KKZ-ve.

### Materialet jo të ndjeshme:

- Ngjyrat e vulës dhe mbushësit;
- Kabinat e votimit;
- Shiritat e papërdorur mbyllës të sigurisë;
- Zarfet e papërdorura;
- Artikuj të ndryshëm të materialit për zyrë (shenja, lapsa, letër etj.);
- Formularët e paplotësuar të ankesave të PZAP-it;
- Në fund vendvotimi duhet të lihet i pastër, orenditë duhet të kthehen në vendin e tyre të duhur. Posterët dhe materiali zgjedhorduhet të largohen.

## VIII TRANSPORTIMI I MATERIALEVE NË DEPO KOMUNALE

### TRANSPORTI NË DEPO TË KOMISIONIT KOMUNAL ZGJEDHOR





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Central Election Commission



**PROCESI I VOTIMIT PËR APO KUNDËR LARGIMIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS  
PROCES GLASANJA ZA ILI PROTIV RAZREŠENJA PREDSEDNIKA OPŠTINE**

**Komuna  
Opština**

**A PAJTOHENI QË EMRI MBIEMRI TË LARGOHET NGA FUNKSIONI  
I KRYETARIT TË KOMUNËS?**

**DA LI SE SLAŽETE DA IME I PREZIME BUDE RAZREŠEN  
FUNKCIJE PREDSEDNIKA OPŠTINE?**

**PO  
DA**

**JO  
NE**



## SHTOJCA 2: FORMULAR I KKZ PRANIM DORËZIM



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



### Formulari i dorëzimit të materialit Obrazac za primopredaju materijala

Me këtë vërtetoj se kam marrë / Ovim potvrđujem da sam primio/la

1. Numri i fletëvotimeve  
Broj glasačkih listića
2. Lista e votuesve me  
Birački spisak sa  faqe  
strane
3. Vula  
Peçat za glasačke listiće  Po  
Da
4. Lapsi matrikular  
Matrikularna boja  Po  
Da
5. Kamera regjistruese  
Kamera za snimanje  Po  
Da Numri serik  
Serijski broj \_\_\_\_\_
6. Për vendvotimin numër  
za broj biračkog mesta  /
7. Dhe konfirmoj se i kam kontrolluar dhe marrë të gjitha materialet jo të ndjeshme  
I potvrđujem da sam proverio i dobio sav neosetljivi materijal  Po  
Da

Kryesuesi i këshillit të vendvotimit ose zëvendëskryesuesi  
Predsedavajući biračkog odbora ili zamenik predsedavajućeg

8. Emri dhe mbiemri  
Ime i prezime \_\_\_\_\_

9. Nënshkrimi  
Potpis \_\_\_\_\_



Anëtar i KKZ-së  
Član OIK-a

10. Emri dhe mbiemri  
Ime i prezime \_\_\_\_\_

11. Nënshkrimi  
Potpis \_\_\_\_\_

### SHTOJCA 3: DIAGRAMI I PAKETIMIT

#### DIAGRAMI I PAKETIMIT / DIJAGRAM ZA PAKOVANJE



Fletëzime e identifikimi / Nisepisat gjashtë listëve

Fletëzime e përditësimi dhe të përditësimi / Nisepisat / Nisepisat gjashtë listëve

Fletëzime e përditësimi dhe të përditësimi / Nisepisat gjashtë listëve / Nisepisat gjashtë listëve

Fletëzime e përditësimi dhe të përditësimi / Nisepisat gjashtë listëve / Nisepisat gjashtë listëve

Vula / Preza

Lapa / Nisepisat / Nisepisat gjashtë listëve

Kulla e identifikimit / Kulla e gjashtë listëve



## SHTOJCA 5: FORMULARI I ANKESËS I PZAP-së



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

### Formulari i Ankesës

E rezervuar për PZAP-in	NUMRI I REGJISTRIT TË VENDIMEVE _____																
Shih faqen vijuese për udhëzime të hollësishme lidhur me mënyrën e parashtrimit të ankesave																	
<b>A. IDENTIFIKIMI I PARASHTRUESIT TË ANKESËS</b>																	
Nëse parashtruesi i ankesës është organizatë apo subjekt politik:																	
1. Emri i organizatës/subjektit politik që parashtron ankesën _____																	
2. Emri i personit të caktuar për kontaktim _____																	
3. Posti i personit të caktuar për kontaktim _____																	
4. Adresa _____																	
5. Komuna _____																	
6. Nr. i telefonit _____ 7. Nr. i faksit _____																	
8. E-maili _____																	
Nëse parashtruesi i ankesës është individ:																	
1. Emri _____																	
2. Përkatësia politike nëse i përket ndonjë subjekti politik _____																	
3. Adresa _____																	
4. Komuna _____																	
5. Nr. i telefonit _____ 6. Nr. i faksit _____																	
7. E-maili _____																	
8. Data e lindjes <table border="1"><tr><td>Data</td><td>Muaji</td><td>Viti</td></tr><tr><td><input type="text"/></td><td><input type="text"/></td><td><input type="text"/></td></tr></table> 9. Numri i regjistrimit civil/ si votues <table border="1"><tr><td><input type="text"/></td><td><input type="text"/></td><td><input type="text"/></td><td><input type="text"/></td><td><input type="text"/></td><td><input type="text"/></td><td><input type="text"/></td><td><input type="text"/></td><td><input type="text"/></td><td><input type="text"/></td></tr></table>		Data	Muaji	Viti	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Data	Muaji	Viti															
<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>															
<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>								
<b>B. KRYESI I SUPOZUAR I SHKELJËS</b>																	
Nëse kryesi i supozuar është individ/organizatë apo subjekt politik:																	
1. Emri i individit/organizatës apo subjektit politik _____																	
2. Posti zyrtar i personit, nëse ka të tillë _____																	
3. Adresa _____																	
4. Komuna _____																	
5. Nr. i telefonit _____ 6. Nr. i faksit _____																	
7. E-maili _____																	



### C. SHKELJA/SHKAKU I ANKESËS

Përshtatni ankesën tuaj në hollësi, duke përfshirë vendin, datën dhe kohën e shkëlqes së pohuar. Lutemi ta përshtatni natyrën e shkëlqes dhe nëse është e mundur të specifikoni dispozitat ligjore që mendoni se janë shkelur. Nëse është e nevojshme, mund të bashkëngjiti fitë shishtë. Bashkëngjitur dërgoni kopjet e çfarëdo dëshmie që mbështet ankesën tuaj.

### D. DËSHMITARI (ËT) E MUNDSHËM (BASHKANGJITUR EDHE DEKLARATAT)

Lutemi të shënoni emrin dhe organizatën ose subjektin politik të cilit i përket dëshmitari(ët) i/e mundshëm. Nëse është e mundur, duhet të shënohen të dhënat për kontaktim (adresa, numri i telefonit, numri i faksit dhe e-maili). Nëse është e nevojshme, mund të bashkëngjiti fitë shishtë.

Sipas njohurive që una posedoj, informacioni i mësipërm është i saktë.  
(Nëse parashtruesi i ankesës është organizatë ose subjekt politik, atëherë atë duhet ta nënshtrojë përfaqësuesit i autorizuar)

Emri dhe Mbiemri \_\_\_\_\_ Nënshkrimi \_\_\_\_\_ Data \_\_\_\_\_

Ky informacion duhet të dorëzohet në adresën: Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)

Rruga "Luan Haradinaj" Ndërrësja e ish Bankës së Lubjanës - Kati I

Prishtinë 10 000 Republika e Kosovës

### PARASHTRIMI I ANKESAVE PRANË PZAP-IT

Çdo person, i cili ka interes ligjor ose që pohon se i janë shkelur të drejtat që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve, mund të parashtrtojë ankesën pranë Panelit të Zgjedhjeve për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP). Kjo në mes tjerash, përfshin, por nuk kufizohet në:

- Apikantët;
- Votuesit;
- Partitë politike, koalicionet, iniciativat qytetare dhe kandidatët e certifikuar;
- Anëtarët e KQZ-së dhe të Sekretariatit të tij;

Për të parashtruar ankesë, duhet të plotësohet formulari i PZAP-it për ankesa. Formulari i ankesave është në dispozicion në gjuhën Shqipe dhe Serbe, në zyrën e PZAP-it në Prishtinë, si dhe në të gjitha Qendrat e Votimeve gjatë ditës së zgjedhjeve.

Që të shpjegohet kjo ankesë, ajo duhet të përmbajë informatat vijuese:

- Pothimin mbi shkeljen e një rregullore të zgjedhjeve, ose të ndonjë urdhërese administrative që ka të bëjë me procesin zgjedhor;
- Përshtatimin sa më të hollësishtëm të pohimit mbi shkeljen/incidentin; dhe
- Nënshkrimin në formular që tregon se të dhënat janë të sakta sipas njohurisë së parashtruesit të ankesës.

Duhet të plotësohen të gjitha rubrikat e zhuaveshme të formularit. Nëse ndonjë rubrikë nuk mund të zbutohet, atëherë duhet të shkruhet si "e parzhuaveshme".

Është me rëndësi të jepet të dhënat për kontaktim të parashtruesit të ankesës, në mënyrë që PZAP-i mund të kontaktojë me parashtruesin e ankesës në rast hetimi dhe pasi të jetë marrë vendimi përfundimtar përkthazi me ankesën.

Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrohet brenda tri ditësh pas pohimit mbi shkeljen ose pasi të jetë i informuar parashtruesi i ankesës për atë shkelje.

Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë ankesë.

Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në Qendren e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga ndodhja e shkëlqes së supozuar.

Parashtrimi i ankesës bëhet drejtpërdrejt në zyrën qendrore të PZAP-it në Prishtinë. Po ashtu ankesa mund të lihen në kutitë postare të PZAP-it që gjenden në Prishtinë dhe në Zyrën e Sekretariatit të PZAP-it. Vendimet përfundimtare të PZAP-it bëhen publike; megjithatë dosjet e fitëve mbeten plotësisht konfidenciale dhe të gjitha hetimet janë konfidenciale.



# PROCEDURAT E VOTIMIT DHE NUMËRIMIT NË VENDVOTIM

KOMISIONI QENDROR  
I ZGJEDHJEVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 69 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 5, nenin 6 dhe nenin 8 të Rregullore Zgjedhore Nr. 02/2024 Emërimi, Përbërja dhe Funkcionimi i Komisioneve Komunale, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 13.04.2024, nxjerr këtë:

## VENDIM

### Për Zëvendësimin e Anëtarit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Komunën e Mitrovicës së Veriut

- I. Z.Ibrahim Deliaj, emërohet anëtar i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve-KKZ, në Mitrovicën e Veriut, nga subjekti politik "Gradanska Inicijativa za Slobodu Pravdu i Opstanak Partija (GISPO)", duke e zëvendësuar anëtarin e z.Branimir Mihajlovic nga subjekti politik (GISPO), për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveqan dhe Mitrovicë e Veriut.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Branimir Mihajlovic nga subjekti politik (GISPO) është emëruar anëtar i KKZ-së, me vendimin e KQZ Nr.01/289-2024 të datës 22 mars 2024, ndërsa po i njëjti me datë 8 prill 2024 ka paraqitur dorëheqjen e tij të parevokueshme në KKZ në komunën e Mitrovicës së Veriut, të pranuar në SKQZ me numër protokolli 08/38-435-2024 datë 8 prill 2024. Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 13.04.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64 paragrafi 2.1 dhe 2.5 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 13.04.2024, nxjerr këtë:

## VENDIM

### Për miratimin e Formave Zgjedhore, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveqan dhe Mitrovicë e Veriut

- I. Miratohen Format Zgjedhore, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveqan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahet me datën 21 prill 2024.
- II. Format si në piken I, janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 13.04.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi



**PROCESI I VOTIMIT PËR APO KUNDËR LARGIMIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS  
PROCES GLASANJA ZA ILI PROTIV RAZREŠENJA PREDSEDNIKA OPŠTINE**

**FORMULARI I VOTIMIT ME KUSHT / OBRAZAC ZA USLOVNO GLASANJE**

**PJESA 1: PARA HAPJES SË VENDVOTIMIT || DEO 1: PRE OTVARANJA BIRAÇKOG MESTA**

1 Numri i vendvotimit  
Broj biraçkog mesta

1201VK



2 Numrat e shiritave për mbylljen e kutisë së votimit me kusht  
Brojevi traka za zatvaranje uslovne glasačke kutije


3 Numri i fletëvotimeve të pranuar  
Broj primljenih glasačkih listića

--	--	--

**PJESA 2: PARA HAPJES SË KUTISË || DEO 2: PRE OTVARANJA KUTIJE**

4 Numri i shiritit për mbylljen e vrimës së kutisë së votimit me kusht  
Broj trake za zatvaranje otvora na uslovnoj glasačkoj kutiji

--

5 Numri i nënshkrimeve në Listën Votuese me Kusht  
Broj potpisa u Uslovnom Biračkom Spisku

--	--	--

6 Numri i fletëvotimeve të papërdorura  
Broj neiskorišćenih glasačkih listića

--	--	--

7 Numri i fletëvotimeve të dëmtuara gjatë ditës  
Broj glasačkih listića oštećenih tokom dana

--	--	--

8 Gjithsej (5+6+7)  
Ukupno (5+6+7)

--	--	--

**PJESA 3: PAS HAPJES SË KUTISË || DEO 3: POSLE OTVARANJA KUTIJE**

9 Numri zarfeve me kusht të gjetura në kutinë e votimit me kusht  
Broj uslovnih koverata koji se nalaze u uslovnoj glasačkoj kutiji

--	--	--

10 Dallimi në mes Rubrikës 5 dhe 9  
Razlika između Rubike 5 i 9

--	--

**PJESA 4: PAS NUMËRIMIT || DEO 4: POSLE PREBROJAVANJA**

11 Numri i shiritit mbyllës të kutisë së zarfeve të fletëvotimeve me kusht  
Broj zaštitnog pečata za kutiju koverti uslovnih glasačkih listića


**PJESA 5: KËSHILLI I VENDVOTIMIT || DEO 5: BIRAÇKI ODBOR**

Kryesuesi (Emri, Mbiemri | Nënshkrimi) / Predsedavajući (Ime, Prezime | Potpis)

--	--

Anëtarët (Emri, Mbiemri | Nënshkrimi) / Članovi (Ime, Prezime | Potpis)


**PROCESI I VOTIMIT PËR APO KUNDËR LARGIMIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS  
PROCES GLASANJA ZA ILI PROTIV RAZRËSHENJA PREDSEDNIKA OPËSTINE**


**FORMULARI I REZULTATEVE  
OBRAZAC ZA REZULTATE**

**KOMUNA / OPËSTINA**

**12 LEPOSAVIQ / LEPOSAVIÇ**

**Numri i vendvotimit  
Broj biraçkog mesta**

**1201 / 01**



Kopja me ngjyrë pembe ekspozohet në vendvotim, FPR-të e mbetura (përfshirë kopertinën) vendosen në Zarfin KKZ  
Shih udhëzimet mbi paketimin e materialeve të ndjeshme në anën e prapme të kopertinës

Kopiju roze boje izložiti na biračkom mestu, ostatak obrasca (uključujući korice) staviti u kovertu za OIK  
Pogledajte uputstva o pakovanju osetljivog materijala na zadnjim koricama

**PROCESI I VOTIMIT PËR APO KUNDËR LARGIMIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS - PROCES GLASANJA ZA ILI PROTIV RAZREŠENJA PREDSEDNIKA OPŠTINE**

**FLETË PUNE / RADNI LIST  
LEPOSAVIQ/LEPOSAVIĆ**

<p><b>1</b> Numri i vendvotimit Broj biraçkog mesta</p> <p><b>2</b> Numrat e shirlave për mbylljen e kapakut të kutisë së votimit Brojevi traka za zatvaranje poklopca glasačke kutije</p> <p><b>3</b> Numri i fletëvotimeve të pranuar Broj primljenih glasačkih listica</p> <p><b>4</b> Numri i shiritit për mbylljen e vrimës së kutisë së votimit Broj trake za zatvaranje otvora na glasačkoj kutiji</p> <p><b>5</b> Numri i nënshkrimeve në Listën e Votuesve Broj popisa u Bračkom Spisku</p> <p><b>6</b> Numri i fletëvotimeve të papërdorura Broj neiskorištenih glasačkih listica</p> <p><b>7</b> Numri i fletëvotimeve të dëmtuara gjatë ditës Broj glasačkih listica oštećenih tokom dana</p> <p><b>8</b> Numri i fletëvotimeve brenda në kuti të votimit Broj glasačkih listica u glasačkoj kutiji</p> <p><b>9</b> Dallimi në mes Rubrikës 5 dhe 8 Razlika između Rubrike 5 i 8</p> <p><b>10</b> Numri i fletëvotimeve të zbraçëta / paplotësura dhe pavlefshme (brenda kutisë) Broj praznih / nepopunjenih glasačkih listica i nevažeći (u kutiji)</p> <p><b>11</b> Numri i fletëvotimeve të vlefshme Broj važećih glasačkih listica</p> <p><b>12</b> Gjithsej fletëvotime të paplotësura, të pavlefshme dhe të vlefshme (10+11) Ukupno broj nepopunjenih glasačkih listica, nevažećih i važećih (10+11)</p> <p><b>13</b> Gjithsej (6+7+12) Ukupno (6+7+12)</p> <p><b>14</b> Dallimi në mes Rubrikës 3 dhe 13 Razlika između Rubrike 3 i 13</p>	<p>Votat / Glasovi / Dylas</p> <p><b>PODA</b></p> <p><b>NE/JO</b></p> <p><b>15</b> Gjithsej vota të vlefshme (Rubrika 11) Ukupno važećih glasova (Rubrike 11)</p>
---	---

PJESA 1: PAS HAPËS SË KUTISË  
DEO 1: POSLE OTVARANJA KUTIJE

**PJESA 4: OKN PAS NUMERIMIA  
DEO 4: POSLE PREBROJAVANJA**

Numri i shiritit mbyllës të thesit 2  
Broj zaštitnog pečata za vrata 2

Numri i shiritit mbyllës të thesit 4  
Broj zaštitnog pečata za vrata 4

Numri i shiritit mbyllës të thesit 1  
Broj zaštitnog pečata za vrata 1

Numri i shiritit mbyllës të thesit 3  
Broj zaštitnog pečata za vrata 3

**PJESA 5: KËSHILLI I VENDVOTIMIT II DEO 5: BIRAČKI ODBOR**  
Kryesuesi (Emri, Mbiemri | Nënshkrimi) / Predsedavajući (Ime, Prezime | Potpis)

Anëtarët (Emri, Mbiemri | Nënshkrimi) / Članovi (Ime, Prezime | Potpis)

PJESA 2: PARA HAPËS SË KUTISË  
DEO 2: PRA OTVARANJA KUTIJE



